REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**
**Nr.07/351/01-13355**
**Dt. 19.06.2017**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Adije (Qazim) Kastrati dhe Bajram (Hasan) Kastrati** nga Gjakova, përmes të **Autorizuarës Znj. Melihate Curri** nga Gjakova, sipas Autorizimit Noterial me nr. LRp.Nr.3398/2017, dt.28.04.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

# AKTVENDIM

**I. I LEJOHET: aplikuesëve: Adije (Qazim) Kastrati dhe Bajram (Hasan) Kastrati** nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim - objekt i banimit individual, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351/01-4213 të datës 29.03.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 4395/23, Z.K. Gjakovë-J-Qytet, në rrugën "Fehmi Agani", në pronësi të lartë përmendurve me nga ½(pjesë ideale), e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit, me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+1, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit **S=377.67 m²**.

| | | |
|---|---|---|
| **Përdhesa:** | **(Sip,Bruto):** | **S= 192.02 m²** |
| **Kati i parë:** | **(Sip,Bruto):** | **S= 185.65 m²** |

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja për projektim dhe ndërtim "ÇETA GENERAL IVEST GROUP"SH.P.K.-Komuna e Istogut.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspekcionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

# A r s y e t i m

**Adije (Qazim) Kastrati dhe Bajram (Hasan) Kastrati** nga Gjakova, me banim në rrugën "Fehmi Agani" nr. 136/2, përmes të **Autorizuarës Znj. Melihate Curri nga Gjakova, sipas Autorizimit Noterial me nr. LRp.Nr.3398/2017, dt.28.04.2017**, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-13355 të datës 17.05.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+1, në ngastrën kadastrale me nr. 4395/23, Z.K: Gjakovë-J-Qytet, në rrugën "Fehmi Agani", në pronësi të lartë përmendurve me nga ½(pjesë ideale), siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 15.08.2016, të punuar nga NPSH"GELI"-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 27.02.2017 në pronësi të Adije (Qazim) Kastrati dhe Bajram (Hasan) Kastrati, me nga ½(pjesë ideale), të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me nr. të lëndës 839/17 të datës 27.02.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimi për Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351/01-4213 të datës 29.03.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastrën kadastrale me nr. 4395/23, ZK: Gjakovë-J-Qytet, të lëshuar nga DUMM.
5. Lejen Ndërtimore – Aktvendimi me nr.05-351-11, 06.07.1987, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm, Punë Komunale e Strehimore i Komunës së Gjakovës, së bashku me Kopjen e Planit.
6. Lejen Ndërtimore – Aktvendimi me nr.05-351-41, 26.05.1988, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm, Punë Komunale e Strehimore i Komunës së Gjakovës.
7. Autorizimin Noterial me nr.LRP.Nr.3398/2017, dt.28.04.2017.
8. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr. 08-320-01-10443, dt.10.05.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
9. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr. 430-a-15, të datës 02.05.2017.
10. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, të datës 12.04.2017.
11. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi", Sh.A.Gjakovë, nr.1016 të datës 07.04.2017.
12. Pëlqimin nga PTK - Gjakovë, datë 04.04.2017.
13. Vërtetimin nga KRM "Çabrati", me nr.374 dt.02.05.2017.
14. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Postën e Kosovës, filiali në Gjakovë me datë 19.06.2017.
15. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, ndërmarrja për projektim dhe ndërtim "ÇETA GENERAL IVEST GROUP"SH.P.K.-Komuna e Istogut.

**Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1438.40 Euro.**

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

**Aktvendimi i dorëzohet:**

- **Investitorit,**
- **Drejtorisë për punë Inspektuese,**
- **Arkivit.**

**Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike**

**Zenel Shabani, jur.dipl.**

**U. D. D r e j t o r i**

**Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.**

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

# KOPJE PLANI

Zona kad. GJAKOVË J. QYTET

Shk. zvog. 1: 2500

Poseduesi: 1/2 KASTRATI BAJRAM (HASAN), 1/2 KASTRATI ADIJE (QAZIM L.STAVICA;

Veriu




Nëpërmjet kësaj dëshmohet se ky dokument është kopja e saktë e origjinalit se përbënet prej 1

Ovim se potvrđuje da je ova kopje identična sa originalom i sastoji se od

This is to certify that this document is an accurate copy of the original and is made up of

Numri i protokolit, Broj protokola, Protocol number

Data/Datum/date:

Komuna e Gjakovës, Opština Đakovica, Gjakova Municipality

Zyrtari për legalizime
Službenik za legalizaciju

Leg.nr/br 1455/17
Dt: 25.05.2017

Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale:

| Nr. Parcelës | Plani | Vendi i quajtur | Kultura | Klasa | Sipërfaqja | | | Vërejtjet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Ha | a | m² | |
| 4395-23 | | | OBORR | – | | 5 | 00 | |
| | | | ARË | 3 | | | 90 | |
| | | | SHTËPI | – | | | 60 | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | Gjithësejtë | | | 6 | 50 | |

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë 27.02 të vitit 2017

VËRTETON:

K.K. GJAKOVË
Z.K. :Gj.j.Qytet
Ng. nr. 4395-23

# PLAN SITUACIONI P=1:500




Lokacioni: Adije Kastrati

*Gjakovë, 29.03.2017*

Gjendja Faktike
Gjendja Kadastrale

*punoi: Fatmir Bobi, tek.gjeod.*

*vërtetoi: Agron Gojani, i.d.a.*

15.08.2016
GPS
Auto CAD 2004

Vërtetoi : N.P.SH."GELI"
DREJTORI

Punoi : Xhelal Zhubi,inxh.dipl.i gjeod.

Frrok Hajdaraj